



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA, MUNICIPAL VITI
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Nenit 14. par.2. të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L125, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik , dhe Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

- Institucioni:** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti
- Titulli i vendit të punës:** 1 (një) pozitë Doktor i Mjekësisë
- Titulli i vendit të punës:** 4 (katër) infermier/e të përgjithshme – për shërbimin e emergjencës dhe punkte shëndetësore
- Kategoria dhe grada e vendit të punës:** - Koeficienti – H – 27 dhe H-68
- Orari:** 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit:** Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212
- Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës Doktor i Mjekësisë:**
- Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan tretmanet, medikamentet dhe aplikon masat tjera shëruese,
 - Urdhëron pacientët në bërjen e analizave bazike laboratorike dhe aplikon procedurat tjera diagnostike,
 - Aranzhon bartjen e pacientëve në spital,
 - Referon pacientët tek specialistët mjekësor dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore,
 - Pranon implementimin e programeve shëndetësore të dizajnuara në nivele më të larta si Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna,
 - Ndihmon në preventimin e sëmundjeve ngjitëse dhe çrregullimeve të ndryshme duke u këshilluar në shëndetin bazik të përgjithshëm.
- Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës Infermier-e të përgjithshme:**
- Pranon, triazon dhe informon pacientin, hap kartelën shëndetësore dhe merrë anamnezën orientuese, aplikon terapinë parenterale, i.m,i.v, subkutan, aplikon infuzionet , bënë inhalimin , përpunimin e plagës, përcjellë kalendarin e imunizimit, aplikon dhënien e oksigjenit, përgjigjet thirrjeve të urgjencave në teren etj. Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe infermieres përgjegjëse.
- Kandidati/ja të cilët konkurrojnë për pozitën **Doktor i Mjekësisë** përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të ketë të përfunduar :
- Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi i mjekësisë së përgjithshme.
- Për vendet e punës **Infermier-e të përgjithshme** kërkohet:
- Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i përgjithshëm
- Dokumentet e kërkuara për të gjithë kandidatët:
- Kopjet e diplomës së shkollimit të kryer
 - Kopjen e licencës së punës valide
 - Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
 - Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.
 - Ekstrakti i lindjes,
 - Çertifikatën që ndaj tij/saj nuk zbatohen hetimet,
 - Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme
- Komuna e Vitisë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Aplikacionet e pakompletuara sipas konkursit si dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
- Detyrat e punës për profilet e kërkuara me konkurs janë parashikuar me Ligjin e Shëndetësisë , Statutin e QKMF-së dhe Qarkoren Informativ 02/2017 nga Ministria e Shëndetësisë.
- Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren fizikisht dhe mund të shkarkohen në webfaqe të komunës së Vitisë si dhe dorëzohen në Zyrën e Arkivës të Komunës së Vitisë nr.1.
- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes.**